

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2026

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	12.01.2026	Kërkohet informacion lidhur me se si parashikohet të funksionojë Inspektorati Qendror dhe a do të marre ky institucion kompetenca nga pushteti vendor.	20.01.2025	Në zbatim të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe vkm nr. 330, datë 11.6.2025 "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm”, emërtimi i institucionit ka ndryshuar nga Inspektorati Qendror në Inspektorati i Përgjithshëm. Në kapitullin II, të ligjit për inspektimin, parashikohen mënyra e organizimit dhe funksionet e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe ndër të tjera, pika 3, nenit 13, të këtij ligji përcakton se: Inspektorati i Përgjithshëm, për inspektoratet vendore, ka këto detyra dhe përgjegjësi: a) koordinon, mbikëqyr ligjshmërinë e veprimtarive inspektuese të inspektorateve vendore, shmanget mbivendosjet e kompetencave me inspektoratet qendrore, mbikëqyr procedurat e rekrutimit, ankimimit dhe largimit të inspektorëve vendorë nga detyra, me qëllim garantimin e	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2026

				respektimit të standardeve në fushën e inspektimit; b) mbikëqyr zbatimin e kërkesave ligjore nga inspektorët vendorë për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procesit të inspektimit. Përsa i përket IMT, Mjedisit, Pyjeve..etj, në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike ndodhet për konsultim publik projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, sipas link-ut të mposhtëm: <u>“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9780, DATË 16.7.2007, “PËR INSPEKTIMIN DHE MBROJTJEN E TERRITORIT NGA NDËRTIMET E KUNDËRLIGJSHME” TË NDRYSHUAR”</u>”		
2.	20.04.2026	Kërkohet vënia në dispozicion e informacionit mbi rezultatet e inspektimit të kryer në pallatin “Arlis”, në zbatim të urdhrit nr. 91, datë 14.04.2026, duke përfshirë përmbledhjen e gjetjeve kryesore, masat e marra ose të rekomanduara, si dhe raportin	29.04.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion lidhur me rezultatet e inspektimit të kryer pranë subjekteve private në pallatin “Arlis”, në Tiranë, ju bëjmë me dije sa vijon: Inspektori i Përgjithshëm, në zbatim të ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 330/2025 “Për organizimin dhe	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2026

		përfundimtar, nëse është i disponueshëm.		funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm”, me urdhër nr. 91, datë 14.04.2026, ka urdhëruar realizimin e një inspektimi pranë subjekteve private në pallatin “Arlis”, me qëllim verifikimin e shkaqeve të aksidentit me pasojë përhapjen e zjarrit. Inspektimi është kryer nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Sektori i Trajtimit të Aksidenteve (STA), më datë 15.04.2026, në adresën: Rruga e Dibrës, pranë Farmacisë 10, Tiranë. Nga verifikimet e kryera rezultojnë se zjarri dyshohet të ketë nisur në një karrocë me ambalazhe kartoni dhe letre të lëna jashtë nga subjekti “Big Market”, ku dyshohet se disa fëmijë kanë luajtur me materialet e djegshme. Nga analiza e vendngjarjes dhe dëshmitë e mbledhura, nuk rezultojnë që zjarri të ketë ardhur si pasojë e defekteve në instalimet apo pajisjet elektrike. Si pasojë e ngjarjes janë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale në fasadën e pallatit, si dhe në apartamentet e brendshme.		
3.	24.06.2026	Kërkohet informacion lidhur me rezultatet e aksionit për lirimin e hapësirave publike gjatë periudhës 2025–qershor 2026, konkretisht	24.06.2026	Autoriteti kompetent për vënien në dispozicion të këtij informacioni është Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit	E deleguar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2026

		mbi numrin e ndërhyrjeve, sipërfaqet e liruara, rastet e përsëritura të zaptimit, vlerësimin e rezultateve të aksionit, rastet e subjekteve të pajisura me leje, si dhe veprimet e ndërmarra nga institucionet në lidhje me rastet e evidentuara në Zvërnec dhe Kakome.				
--	--	---	--	--	--	--